



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.16

2001

Prill

P Ë R M B A J T J A

Dekret nr.2962 datë 09.04.2001	Për emërimin e anëtarit të Gjykatës së Lartë.....	481
Dekret nr.2666 datë 13.04.2001	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Këshillin e Komunës Bërxull	481
Dekret nr.2967 datë 18.04.2001	Për caktimin e datës së zgjedhjeve të Kuvendit.....	482
Vendim i KM nr.129,datë 15.3.2001	Për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në Qendrën Rajonale të Nismës së Bashkëpunimit për Europën Juglindore (Qendra SECI), për luftën kundër krimit ndërkufitar.....	482
Vendim i KM nr.131, datë 15.3.2001	Për shpronësimin, për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Vorë-Sukth, në Muçaj-Vorë, të qarkut të Tiranës, pjesë e superstradës rrugore Tiranë-Durrës.....	484

Vendim i KM nr.135, datë 15.3.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr.60, datë 27.2.1992, Të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve”.....	485
Vendim i KM nr.139, datë 22.3.2001	Për miratimin e rregullores për bashkërendimin e veprimeve të organeve të kontrollit shtetëror dhe joshtetëror në Aeroportin Ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë.....	486
Vendim i KM nr.151, datë 22.3.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.230, datë 22.7.1991, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e komisioneve të tokave”.....	496
Vendim i KM nr.152, datë 22.3.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.831, datë 28.12.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore”.....	497
Vendim i KM nr.153, datë 22.3.2001	Për procedurat e operacioneve financiare në zbatim të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, ndryshuar me ligjin nr.8640, datë 24.7.2000.....	498
Vendim i KM nr.156, datë 22.3.2001	Për shkollat e larta jopublike në Republikën e Shqipërisë.....	499
Vendim i KM nr.167, datë 30.3.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.....	502
Vendim i KM nr.221, datë 13.4.2001	Për administrimin dhe shitjen e mallrave të konfiskuara në mbështetje të ligjit nr.8717, datë 15.12.2000 “Për vendosjen e pullave në artikujt e duhanit e të pijeve alkoolike”.....	503
Vendim i KM nr.223, datë 13.4.2001	Për vlerësimin cilësor të markave të cigareve të pranishme në tregun shqiptar.....	505
Vendim i KM nr.224, datë 13.4.2001	Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve.....	506
Udhëzim i KQZ nr.19, datë 24.03.2001	Për një shtesë në udhëzimin e KQZ-së nr.18, datë 11.03.2001.....	507
Udhëzim i KQZ nr.20, datë 27.03.2001	Për një shtesë në udhëzimin e KQZ-së nr.18, datë 11.03.2001.....	508
Udhëzim i KQZ nr.21, datë 05.04.2001	Për vendosjen e kopjeve origjinale të tabelave, procesverbaleve dhe vulës së KQV-së në kutinë e votimit që përmban fletët e votimit për deputetët në zonën njëmërore.....	509
Udhëzim i KQZ nr.22, datë 09.04.2001	Për caktimin e vëzhguesve pranë qendrave të votimit dhe komisioneve zgjedhore.....	509

D E K R E T
Nr.2962, datë 9.4.2001

PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 36 pika 1 të Kushtetutës, bazuar në pëlqimin e dhënë nga Kuvendi, me vendim nr.485, datë 5.4.2001,

D E K R E T O J:

Neni 1

Zonja Irma Hilmi Bala emërohet anëtare e Gjykatës së Lartë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

D E K R E T
Nr.2966, datë 13.4.2001

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE
PËR KËSHILLIN E KOMUNËS BËRXULL

Në mbështetje të nenit 115, pika 3, të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë“, për shkak të shpërndarjes së Këshillit të Komunës Bërxull të Qarkut Tiranë, bazuar në shkresën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.327/1, datë 9.4.2001,

D E K R E T O J:

Neni 1

Zgjedhjet për Këshillin e Komunës Bërxull të Qarkut Tiranë të zhvillohen ditën e dielë, datë 6 maj 2001.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

D E K R E T
Nr.2967, datë 18.4.2001

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN

Në mbështetje të nenit 92, germa “gj” të Kushtetutës, si dhe të nenit 4, të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

D E K R E T O J:

Neni 1

Zgjedhjet për Kuvendin të zhvillohen ditën e dielë, datë 24 qershor 2001, ndërsa raundi i dytë i këtyre zgjedhjeve të zhvillohet ditën e dielë, datë 8 korrik 2001.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr.129, datë 15.3.2001

PËR PËRFAQËSIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË QENDRËN RAJONALE TË NISMËS SË BASHKËPUNIMIT PËR EUROPËN JUGLINDORE (QENDRA SECI), PËR LUFTËN KUNDËR KRIMIT NDËRKUFITAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 13 të “Marrëveshjes së SECI-t për bashkëpunimin për parandalimin dhe luftën kundër krimit ndërkufitar”, të ratifikuar me ligjin nr.8541, datë 21.10.1999, të pikave 5.1 (5.1.3) dhe 5.2 (5.2.3), të “Kartës për organizimin dhe funksionimin e qendrës rajonale të nismës së bashkëpunimit për Europën Juglindore (Qendra SECI), për luftën kundër krimit ndërkufitar”, të ratifikuar me ligjin nr.8639, datë 13.7.2000, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2001”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në Qendrën Rajonale (SECI) të luftës kundër krimit të organizuar ndërkufitar, me seli në Bukuresht, Rumani, të krijuar në kuadër të nismës së bashkëpunimit të Europës Juglindore, më 1 nëntor 2000.

Përfaqësimi të realizohet me dy punonjës (nëpunës ndërlidhës), të cilët të emërohen njëri nga Ministri i Financave dhe tjetri nga Ministri i Rendit Publik, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Emërimi i nëpunësve ndërlidhës përkatësisht nga Ministri i Financave dhe Ministri i Rendit Publik, bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregulloret e brendshme të Qendrës Rajonale (SECI).

3. Nëpunësit ndërlidhës të emërohen për një periudhë të përcaktuar shërbimi, më e pakta dy vjet, dhe emërimi i tyre t'i njoftohet zyrtarisht Sekretariatit të Përgjithshëm të Qendrës Rajonale (SECI).

4. Nëpunësit ndërlidhës, gjatë veprimtarisë së tyre në këtë Qendër, janë dhe mbeten organikë e institucioneve që i emërojnë. Në përfundim të misionit të tyre, nëpunësit ndërlidhës gëzojnë të drejtën e rikthimit në institucionin ku kanë punuar para emërimit në këtë detyrë.

5. Nëpunësit ndërlidhës, gjatë veprimtarisë së tyre në Qendrën Rajonale (SECI), përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e Republikës së Shqipërisë, duke ruajtur respektivisht karakteristikat dhe cilësitë e nëpunësit specialist doganor dhe të punonjësit të Policisë së Shtetit.

6. Statusi, imuniteti dhe privilegjet që gëzojnë nëpunësit ndërlidhës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në Qendrën Rajonale (SECI) rregullohen në përputhje me "Marrëveshjen bazë (Headquarters Agreement) të nismës së bashkëpunimit të Europës Juglindore dhe Rumanisë", nënshkruar më 2 tetor 2000, ndërmjet Komitetit të Përbashkët të Bashkëpunimit të Qendrës Rajonale (SECI) dhe qeverisë rumune, si dhe në përputhje me legjislacionin përkatës, kombëtar.

7. Nëpunësit ndërlidhës, në vend të pagës, marrin alokacione në valutë, të cilat përlllogariten në bazë të rëndësisë së veçantë të Nismës së Bashkëpunimit të Europës Juglindore, në bazë të mbështetjes politike që gëzon ajo nga partnerët euroatlantikë, të statusit të organizmit ndërkombëtar të Qendrës (SECI) dhe të rekomandimeve të Komitetit të Përbashkët të Bashkëpunimit të kësaj Qendre.

Alokacionet janë në përpjestim me suksesin dhe rreziqet që mbart lufta kundër krimit të organizuar ndërkufitar.

8. Masa e alokacioneve për nëpunësit ndërlidhës paraqitet në lidhjen nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe përbëhet nga alokacioni individual dhe shtesa për profesionin. Përveç alokacioneve, nëpunësit ndërlidhës përfitojnë dhe prime motivuese, vlera e të cilave bazohet në meritat individuale dhe në nivelin e realizimit të detyrave. Sistemi i pagesës së parimeve do të jetë ai që zbatohet nga secila prej administratave përkatëse.

9. Nëpunësit ndërlidhës, bashkëshortët dhe fëmijët në ngarkim, gjatë veprimtarisë së tyre në Qendrën Rajonale (SECI) dhe në lidhje me të, nëse nuk përcaktohet ndryshe këtu, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe përfitimet që parashikon ligji nr.8370, datë 9.7.1998 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij.

10. Për efekt të zbatimit të pikës 9 të këtij vendimi, nëpunësi ndërlidhës barazvlerësohet me gradën e këshilltarit të përfaqësisë diplomatike.

11. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga fondet jobuxhetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për njërin punonjës dhe për tjetrin nga fondet buxhetore të Ministrisë së Rendit Publik.

12. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Rendit Publik për nxjerrjen e një udhëzimi të përbashkët për ngritjen dhe funksionimin e pikës së vetme kombëtare të kontaktit të parë, për realizimin e shkëmbimit të informacionit me Qendrën Rajonale (SECI), jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

13. Në organikën e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit shtohet funksioni "nëpunës ndërlidhës".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LIDHJA 1
STRUKTURA E PAGËS SË NËPUNËSIT NDËRLIDHËS NË QENDRËN RAJONALE TË
NISMËS SË BASHKËPUNIMIT TË EUROPËS JUGLINDORE (QENDRA SECI) PËR LUFTËN
KUNDËR KRIMIT NDËRKUFITAR

Varianti 1: Pagesa e nëpunësve ndërlidhës financohet pjesërisht nga Qeveria e SHBA (50%:50%)

EMËRIMI	ALOKACIONI MUJOR I PAGUESHËM				
	ALOKACIONI INDIVIDUAL (Në USD)			SHTESA PROFESIONALE (Në USD)	
	Baza	Shtesa për vjetërsi në %	Shtesa për kualifikim në %	Shtesa për funksion në vlerë	Shtesa për kushte pune në vlerë
Nëpunës ndërlidhës	400	2% e bazës për çdo vit pune	50-100	200	300

Varianti 2: Pagesa e nëpunësve ndërlidhës përballohet nga shteti shqiptar

EMËRIMI	ALOKACIONI MUJOR I PAGUESHËM				
	ALOKACIONI INDIVIDUAL (NË USD)			SHTESA PROFESIONALE (NË USD)	
	Baza	Shtesa për vjetërsi në %	Shtesa për kualifikim në %	Shtesa për funksion në vlerë	Shtesa për kushte pune në vlerë
Nëpunës ndërlidhës	800	2% e bazës për çdo vit pune	50-100	400	600

V E N D I M
Nr.131, datë 15.3.2001

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR VORË-SUKTH, NË MUÇAJ-VORË, TË QARKUT TË TIRANËS, PJESË E SUPERSTRADËS RRUGORE TIRANË-DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Vorë-Sukth, në Muçaj-Vorë, të qarkut të Tiranës, pjesë e superstradës rrugore Tiranë-Durrës.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 4 185 100 (katër milionë e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2001, miratuar për Ministrinë e Transportit, në zërin “Shpronësime për vitin 2001”.

5. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 28.3.2001.

6. Ngarkohet Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

RRETHI TIRANË

BASHKIA VORË

FSHATI VORË

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SUPERSTRADËS VORË-SUKTH, PJESË E SUPERSTRADËS TIRANË-DURRËS

Lloji i pasurisë së paluajtshme

Nr.	Emër Mbiemër	Adresa	Nr.1 km	Sip.m2 truall/tokë are	Çmimi i truallit lekë/m2	Tokë are çmimi lekë/m2	Vlera në lekë
1.	Luigji Aliaj	Shkodër		519/1510	4300	1200	4043700
	Leonardo Kastrati	Durrës					
	“Uldedaj Liss”sh.p.k.	Tiranë					
	Paulin Sterkaj	Tiranë	1 + 1000				
2.	Shpenzime procedurale						141400
	SHUMA						4185100

V E N D I M

Nr.135, datë 15.3.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.60, datë 27.2.1992, të Këshillit të Ministrave bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës së ushtarakut aktiv të jetë 9 000 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (zëvendëskomandant i FT, etj), të jetë 34 400 lekë në muaj.

b) Në pikën 2, paga e ushtarakëve aktivë të shërbimit të detyrueshëm ushtarak dhe e studentëve ushtarakë të jetë deri 1 000 lekë në muaj.

c) Në pikën 5 paragrafi i tretë, paga për ushtarin rezervist të jetë deri 700 lekë në ditë.

ç) Paga mujore për funksionet ushtarake të mëposhtme të jetë:

- Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA78 000 lekë
- Zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe komandant i Forcave Tokësore70 000 lekë
- Komandant i Forcave Detare dhe komandant i Forcave Ajrore65 000 lekë
- Komandant i Doktrinave dhe komandant i Komandës Logjistike61 000 lekë
- Këshilltar i Ministrisë dhe drejtor drejtorie

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2001, për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.139, datë 22.3.2001

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR BASHKËRENDIMIN E VEPRIMEVE TË ORGANEVE TË KONTROLLIT SHTETËROR DHE JOSHTETËROR, NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të shkronjës “ë” të nenit 3 të ligjit nr.8310, datë 19.3.1998 “Për sigurinë në aviacionin civil”, me propozimin e Ministrisë të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Rregullore për bashkërendimin e veprimeve të organeve të kontrollit shtetëror dhe joshtetëror, në Aeroportin Ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

RREGULLORE PËR BASHKËRENDIMIN E VEPRIMEVE TË ORGANEVE TË KONTROLLIT SHTETËROR DHE JO SHTETËROR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË RINASIT

Neni 1
Qëllimi

1.1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të vendosë marrëdhënie të harmonizuara ndërmjet subjekteve shtetërore e private që operojnë në aeroport dhe është e detyrueshme për zbatim nga të gjithë.

Neni 2
Shërbimet aeroportuale

Shërbimet që kryhen në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit janë si më poshtë:

2.1. Shërbimet operacionale bazë:

- I. Sh.a. Albtransport
 - 1. Handlingu
 - 2. Mirëmbajtje
 - 3. Zjarrfikëse
 - 4. Shëndetësore
 - 5. Sigurie
 - 6. Ndriçimi
- II. Sh.a.ANTA
 - 7. Kontrolli Trafikut Ajror
 - 8. Meteorologjisë
 - 9. Ndërlidhjes
- III. Komisiariati i Policisë së Rinasit
 - 10. Kufiri
 - 11. Sigurie
- IV. Dega e Doganës
 - 12. Doganor
 - 13. Sigurie
- V. Ministria e Mbrojtjes
 - 14. Kërkim-shpëtim
- VI. Protokollu qeveritar
 - 15. Shërbimi VIP
- A. Shërbimet Ndihmëse dhe Komerciale
 - I. Sh.a. Albtransport
 - 1. Pastrim-Gjelbërim
 - 2. Furnizimit me energji elektrike, ujë etj.
 - II. Subjekte të ndryshme
 - 3. Telefonike, bankare
 - 4. Tranzitit (Duty free shop, bar-bufë, restorante etj)
 - 5. Chateringut

Neni 3 Legjislacioni

Gjithë aktiviteti i Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit mbështetet në zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar që është në fuqi:

- A. Legjislacioni bazë kombëtar
 - Ligji “Për Aviacionin Civil Shqiptar”, nr.7877, datë 30.11.1994.
 - Ligji “Për sigurinë e Aviacionit Civil Shqiptar”, nr.8310, datë 19.3.1998.
 - Ligji “Për Policinë Kufitare”, nr.8342, datë 6.5.1998.
 - Ligji “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë“, nr.8449, datë 27.1.1999, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me veprimtarinë doganore.
 - Ligji “Për përdorimin e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë“, nr.8374, datë 15.7.1998.
 - Ligji “Për Shoqëritë Tregtare”, nr.7638, datë 19.11.1992.
 - Ligji “Për Bankën” mbi import-eksportin e valutës, nr.8076, datë 22.2.1996.
- Ligji “Mbi Gardën e Republikës”, nr.7602, datë 9.9.1992, ndryshuar me të fundit nr.8452, datë 28.1.1999, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me fushën e kësaj rregulloreje.
- 3.3. Legjislacioni bazë ndërkombëtar
 - Konventa e ICAO-s “Për Aviacionin Civil Ndërkombëtar”, (së bashku me të gjitha anekset përkatëse), aderuar nga Republika e Shqipërisë me dekretin nr.7438, datë 1.12.1990.
 - Konventa e Varshavës “Për unifikimin e disa rregullave të Transportit Ajror Ndërkombëtar”, aderuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.8150, datë 11.9.1996.

- Konventat “Për kundërvajtjet dhe akte të tjera të kryera në bordin e avionit”, nënshkruar në Tokio më 14.9.1963 “Për ndërhyrjet e akteve të paligjshme të rrëmbimit të avionëve, nënshkruar në Hagë, më 16.12.1970, dhe “Për ndërhyrjet e akteve të paligjshme ndaj sigurisë së aviacionit civil”, nënshkruar në Montreal më 23.9.1971, aderuar nga Republika e Shqipërisë, me ligjin nr.8197, datë 6.3.1997.

- Marrëveshja “Për shërbimet tranzite ajrore ndërkombëtare”, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, me ligjin nr.8197, datë 6.3.1997.

- Standardet dhe Rregulloret e Aviacionit Civil Ndërkombëtar, si ECAC, IATA, EUROCONTROL, ACI etj.

- Marrëveshjet Qeveritare të Transportit Ajror Civil, të bëra midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të tjera për përdorimin e tregut ajror të secilit vend, mbi bazë reciprociteti.

Neni 4 **Kontratat**

Gjithë aktiviteti i shërbimeve që Aeroporti Ndërkombëtar i Rinasit kryen ndaj pasagjerëve, mallrave dhe avionëve të shoqërive ajrore shqiptare dhe të huaja është i bazuar në procedurat standarde të operimit, të përcaktuara në kontratat që këto shoqëri ajrore kanë lidhur me subjektet e tjera që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit.

Neni 5 **Orari i operimit**

5.1. Oraret e operimeve dhe ndryshimet në to propozohen nga shoqëritë ajrore dhe miratohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, e cila nëpërmjet ANTA-s njofton Qendrën Operacionale të Sovranitetit Ajror të Forcave Ajrore (QOSA).

Asnjë ndryshim oraresh nuk mund të bëhet pa miratimin paraprak të DPAC.

Neni 6 **Njoftimi për charter**

6.1. Për të gjithë avionët që do të vijnë jashtë orarit të planifikuar (Charter), bëhet kërkesa nga operuesi pranë DPAC-së.

DPAC-ja, me strukturat e veta, pas dhënies së lejes, duhet të njoftojë të gjithë organet që operojnë në Aeroport.

6.2. Në çdo rast njoftimi përmban:

- a) shtetin të cilit i përket avioni;
- b) shoqërinë ajrore të cilës i përket avioni;
- c) tipin e avionit;
- d) shenjën dalluese të avionit;
- e) sinjalin e thirrjes në radiofoni;
- f) mbiemri, emrin e kapitenit të avionit;
- g) përbërjen e ekuipazhit;
- h) numrin e udhëtarëve dhe shtetësinë e tyre;
- i) llojin e ngarkesës;
- j) kohën e kalimit në pikën e kufirit ajror shtetëror të Republikës së Shqipërisë;
- k) qëllimin e fluturimit;
- l) kohën e mbërritjes dhe qëndrimit në Aeroportin e Rinasit.

6.3. Të gjitha fluturimet e miratuara kryhen sipas planit të saktë të fluturimit që i dërgohet aeroportit të mbërritjes 30 minuta përpara nga aeroporti i nisjes.

6.4. Ekuipazhi i avionit, hyn në lidhje me qendrën e Kontrollit të Trafikut Ajror, 20 minuta para kalimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7 **Praktika e lirë**

7.1. Në zbatim të legjislacionit në fuqi, organizohet për pritje dhe nisje të avioneve në Aeroportin e Rinasit, grupi i praktikës së lirë si më poshtë:

- a) Albrtransporti (axhenti i Degës së Shërbimit në Tokë);
- b) Policia Kufitare;
- c) Autoriteti doganor (përfaqësuar nga doganieri);
- d) Albrtransporti (mjeku);
- e) Përfaqësuesi i shoqërisë në Shqipëri.

7.2. Grupi njoftohet nga Dega e Shërbimit në Tokë (Albrtransport) që merr njoftime për fluturimet e planifikuara dhe Charter nga Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror dhe njofton të gjitha subjektet e tjera.

7.3. Si në mbërritje dhe në nisje, marrëdhëniet me kapitenin e avionit mbahen nga axhenti i Degës së Shërbimit në tokë të Albrtransportit në bashkëpunim me doganierin dhe punonjësën e policisë kufitare në aeroport të përcaktuar në grafik. Pasi avioni është liruuar nga pasagjerët, si rregull, autoriteti doganor ushtron mbikëqyrje në bordin e avionit. Policia e kufirit kryhen kontrollin terminal. Autoriteti doganor pasi njihet me manifestin dhe konstaton rregullsinë e mallrave në bord, jep miratimin për shkarkimin e tyre, në rast se konstaton mallra të ndalura, si lëndë toksike, mallra të skaduar etj., nuk lejon shkarkimin e tyre. Mjeku është i pranishëm në rast se nuk njoftohet.

7.4. Axhenti, me marrjen e kontaktit në mbërritje, me kapitenin e avionit organizon përpunimin e tij duke u lidhur me gjithë subjektet e tjera dhe në nisje, po ashtu merr takim me kapitenin, me të cilin mbyll dokumentacionin dhe njofton përfundimin e përpunimit të Kulla e Trafikut Ajror.

Neni 8 **Përpunimi i avionit**

8.1. Në mbërritje

Me mbërritjen e avionit të linjës ose charter në vendqëndrim, komanda e avionit ul shkallët ose shërbimi i handlingut i aeroportit afron shkallët, sapo merr sinjalin nga marshalli që avioni është gati për përpunim.

a) Policia kufitare lejon zbritjen e pasagjerëve, duke siguruar lëvizjen e tyre deri në pikën e kontrollit kufitar e doganor për hyrje.

b) Lejohet afrimi i punëtorëve dhe pajisjeve të shkarkimit të bagazheve e mallrave kur janë të pranishëm, punonjësi i doganës, sigurisë, axhenti i cargos e postës dhe, sipas rastit, persona të tjerë të autorizuar.

c) Me zbritjen e pasagjerëve në avion, hyjnë punonjësit e pastrimit dhe lejohet furnizimi i avionit me karburant dhe ngarkimi i bagazheve e mallrave për nisje.

8.2. Në nisje

a) Me përpunimin e check-in dhe përgatitjen e pasagjerëve dhe dokumentacionit përkatës lejohet futja e pasagjerëve në bord, kur rreth avionit gjithçka është e lirë dhe nuk kryhet asnjë aktivitet tjetër veç furnizimit me energji elektrike për ndezje motorash.

b) Axhenti njofton shërbimin e parkingut që avioni është gati për nisje dhe fillojnë manovrat, pasi jepet leja nga kulla, e cila ka njoftuar qendrën e kontrollit të trafikut ajror, dhe pasi ka marrë miratimin nga grupi i praktikës.

c) Marshallimi bëhet pasi piloti merr leje nga kulla dhe njoftohet edhe ky për lejimin e fillimit të manovrave nga vendqëndrimi.

Neni 9 **Ndalimi i avionit**

9.1. Avioni ndalohet në parking në këto raste:

- a) Kontrolli nga DPAC ka konstatuar se dokumentacionit të avionit i ka kaluar afati, sidomos certifikatës së vlefshmërisë ajrore të operimit.
- b) Organet e policisë dhe doganës dyshojnë për mbërritje droge, armë dhe arikuj të ndaluar, që hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa u deklaruar dhe ushtrojnë kontroll në avion.
- c) Kur ka njoftim nga çdo burim dhe pavarësisht nga besueshmëria për bombë në bordin e avionit ose në çanta e bagazhe të ndonjë pasagjeri në bord.
- d) Në raste avarie të avionit, bllokimit nga vetë ekuipazhi ose nga njoftimi i vetë shoqërisë së tij.
- e) Në rast kohe të keqe.
- f) Për rastet kur siguria e brendshme në vendqëndrimin e avionit nuk lejon kryerjen e veprimeve, si rrjedhojë e veprimeve terroriste.
- g) Bllokimi bëhet dhe për raste të ndalimit të fluturimeve në hapësirën ajrore kur ajo përdoret për qëllime emergjente ose për interesa të tjera shtetërore.

Neni 10

Qendra e Kontrollit të Trafikut Ajror

10.1. Me përfundimin e përpunimit të avionit në aeroport, shërbimet e Albtransportit njoftojnë Qendrën e Kontrollit të Trafikut Ajror, e cila nga ana e saj i jep leje komandantit të avionit dhe kapitenit të fillojnë manovrat e lëvizjes nga vendqëndrimi në parking për të kaluar në taxiway (rrugët lidhëse), të dalë në pistë, duke përshkruar procedurën e përcaktuar dhe duke mbajtur lidhje të vazhdueshme me Qendrën e Kontrollit të Trafikut Ajror. Kjo ndërlidhje me avionin vazhdon deri në kufirin ajror të Republikës së Shqipërisë, mbas të cilit kontrolli i delegohet Qendrës së Kontrollit të Trafikut Ajror të shtetit fqinj. E gjithë praktika zhvillohet në bazë të standardeve të shërbimeve të përcaktuara nga ICAO-ja dhe marrëveshjeve të lidhura ndërmjet qendrave të kontrollit të trafikut ajror.

10.2. QKTA-ja është qendër operuese e përbashkët civilo-ushtarake me drejtim civil. Detyrat e koordinimit të veprimtarive përcaktohen me rregullore të veçantë.

Neni 11

Masa sigurie

11.1. Për zbatimin e masve të sigurisë, të përcaktuara në ligjin nr.8310, datë 19.3.1998 “Për sigurinë në Aviacionin Civil Shqiptar”, pikat kryesore të hyrjeve do të jenë:

a) Gjithë punonjësit e Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit hyjnë nëpërmjet portave 12 dhe 6, në të cilat organizohet kontrolli policor, doganor e i sigurisë.

b) Hyrja e automjeteve teknologjike dhe e automjeteve të blinduara të bankës, mjeteve që marrin ndihma në raste të veçanta me autorizim për përpunim avioni, bëhet nëpërmjet portës A.

(Varianti i Ministrisë së Transportit).

c) Fletëhyrjet për personat fizikë apo mjetet e transportit në aeroport, si ato ditore, dhe vjetore, përgatiten nga organi i sigurisë në aeroport dhe miratohen nga DPAC-ja.

Lejet e lëshuara nga Drejtoria e Kufirit, konfirmohen nga autoriteti përgjegjës i sigurisë në aeroport.

d) Porta B, C janë të gadishmërisë, ku hyjnë vetëm avionët e repartit ushtarak.

e) Kalimi i pasagjerëve bëhet vetëm në hyrjen 6.

11.2. Kalimi i pasagjerëve lejohet kur:

a) Kanë kryer kontrollin në check-in dhe janë pajisur me boarding-pass.

b) Pasagjerët që janë të Komunitetit Europian (E.C) kalojnë në kontroll kufitar e doganor dhe vulozet vetëm boarding-pass.

c) Pasagjerëve shqiptarë u vendoset vetëm vula e daljes në pasaportë, u kontrollon biletat, viza dhe kuponin i hyrjes në avion.

d) Pasagjerit shqiptar në ardhje i vulozet vetëm pasaporta.

e) Pasagjeri i E.C., në ardhje, dorëzon kuponin dhe i vulozet pasaporta.

f) Në rast se dyshohet, cilido qoftë ai pasagjer, nxirret nga rradha dhe i bëhet verifikimi në vendin e specializuar.

11.3. Në hyrjen 8 ose daljen e pasagjerëve, kur kemi mbarkuar në bordin e avionit, shërbimi bëhet nga personeli i sigurisë së Albtransportit, ku asiston edhe policia kufitare.

Neni 12

Autoriteti Aeronautik Shqiptar

a) Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil Shqiptar, është autoriteti i vetëm aeronautik Shqiptar përgjegjës për aktivitetet në fushën e transportit ajror civil.

b) Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil Shqiptar, në bashkëpunim me Komitetin e Sigurisë në Aeroport, përcakton zonat e sigurisë, zonat e kontrollit dhe zonën tranzite. Hyrja, dalja dhe ushtrimi i çdo lloj aktiviteti në zonën e kontrollit, zonën e kufizuar dhe zonën tranzite bëhet në bazë të rregullores së regjimit të hyrejeve në aeroport, e miratuar nga Komiteti i Sigurisë.

Neni 13

Plani i emergjencës

Për rastet e jashtëzakonshme dhe situata të veçanta, sipas programit të sigurisë dhe emergjencës, Komisariati i Policisë bashkërendon veprimet me të gjitha strukturat operuese në Aeroport.

PJESA II

DETYRAT E VEÇANTA TË SUBJEKTEVE QË OPEROJNË NË AEROPORT

Neni 14

Sh.a. Albtransport

15.1. Sh.a. Albtransport është përgjegjës për:

a) kryerjen e shërbimeve aeroportuale e të përpunimit të avionëve për transportin e udhëtarëve, bagazheve, mallrave dhe postës.

b) vendosjen, mirëmbajtjen dhe operimin e të gjitha sistemeve të kryerjes së shërbimeve, në përputhje me të gjitha rregullat, standardet e rekomandimet e bëra nga Autoriteti Aeronautik Shqiptar (Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil).

c) zbatimin në mënyrë të rregullt të të gjitha udhëzimeve që jepen nga ministri përgjegjës për transportin dhe nga Autoriteti Aeronautik Shqiptar.

d) shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit dhe të gjithë infrastrukturës përkatëse që ndodhet në të.

e) vendosjen dhe zbatimin e ligjit të sigurisë së aviacionit civil në Aeroport.

f) funksionimin e Komitetit të Sigurisë së Aviacionit Civil në Aeroport.

15.2. Sh.a. Albtransport është përgjegjës për përpunimin e avionit në kohë dhe për zbatimin e masave të sigurimit teknik (safety) dhe të sigurisë së shërbimit (security), në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Rinas dhe Degën e Doganës, Rinas.

15.3. Për të përcaktuar përgjegjësitë ndaj subjekteve të tjera sh.a. Albtransporti, në përputhje me zbatimin e detyrimeve të saj, lidh marrëveshje me subjektet që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit.

Neni 15

Sh.a. ANTA

15.1. Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror (sh.a. ANTA) është përgjegjëse për:

a) garantimin e sigurisë së fluturimeve ajrore, për dhe nga Aeroporti Ndërkombëtar i Rinasit, në të gjithë hapësirën ajrore shqiptare, duke bërë kontrollin dhe drejtimin e lëvizjes së avionëve (civilë dhe ushtarakë) që fluturojnë në të.

b) zbatimin në mënyrë të rregullt të të gjitha udhëzimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe që jepen nga ministri që mbulon fushën e transporteve dhe Autoriteti Aeronautik Shqiptar (Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil), për kryerjen e fluturimeve në rrugët e shërbimit të trafikut ajror, si edhe për avionët ushtarakë stërvitorë.

c) dhënien e informacionit të nevojshëm të avionëve, për rrugët ajrore, të dhënat meteorologjike etj.

d) instalimin, mirëmbajtjen dhe operimin e të gjitha sistemeve të nevojshme të navigimit, komunikimit, meteorologjisë, etj, në përputhje me rregullat, standardet e rekomandimet e Autoritetit Aeronautik Shqiptar (DPAC).

e) njoftimin e koordinimin për dhënien e ndihmës së nevojshme për aviacionet civile dhe ushtarake në rast fatkeqësie.

15.2. Për të gjitha oraret e fluturimeve charter, si dhe për çdo ndryshim të orareve të fluturimeve të rregullta të shoqërive ajrore që operojnë në Aeroportin e Rinasit, pas marrjes së miratimit nga Autoriteti Aeronautik Shqiptar (Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil), sh.a. ANTA njofton çdo ditë sh.a. Albtransport, degën e Doganës, QOSA-n e FA-së dhe Policinë kufitare në orën 730., por jo më vonë se 30 minuta përpara nisjes së avinit (07-2000).

15.3. Të gjithë avionët që ulen në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit deri në momentin e parkingut, janë nën përgjegjësinë e sh.a ANTA-s, e cila nëpërmjet Shërbimit të Kontrollit të Trafikut Ajror bashkërendon me sh.a. Albtransport për gadishmërinë e ndriçimit dhe të pistës, rrugëve lidhëse e të vendqendrimit. Për çdo vonesë të avionit si rrjedhojë e mosgadishmërisë së pistës, rrugëve lidhëse dhe vendqendrimit të avionëve, përgjegjësia bie mbi Sh.a Albtransport.

15.4. Me njoftimin nga shërbimet e specializuara të sh.a. Albtransport se avioni është gati për ngritje dhe vendosjen e ndërlidhjes direkt me kryepilotin nga vendqendrimi, në ngritje e fluturim deri në pikën kufitare ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe dorëzimin e tij tek ATC-ja (Qendra e Kontrollit të Trafikut Ajror) fqinjë, në bazë të marrëveshjeve të bëra ndërmjet tyre.

Neni 16

Policia

16.1. Komisariati i policisë së Rinasit është nën varësi të Ministrisë së Rendit Publik dhe bashkërendon punën me organizmat e tjera që operojnë në Aeroport, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe neneve të kësaj Rregulloreje. Detyrat e saj janë:

a) Parandalimi dhe zbulimi i veprave penale të cilat mund të përbëjnë rrezik për aviacionin civil.

b) Ruajtja dhe patrullimi i zonave në Aeroport.

c) Kryerja e kontrollit të dokumentacionit identifikues të çdo personi që kalon nëpërmjet vendkalimit kufitar të Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit.

d) Parandalimi i kalimit të paligjshëm të kufirit, të trafikut të armëve, të drogës, të substancave psikotrope e radioaktive, të veprave të artit e muzeale dhe vlerave valutore.

e) Zbatimi i masave të sigurisë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, për parandalimin e zbulimin e veprave penale të cilat përbëjnë rrezik e krijojnë incidente të rënda dhe raste të jashtëzakonshme, si grabitje aviacioni, sabotazh apo kërcënim me bomba.

16.2. Në rastet kur policia ka dyshime apo vihet në dijeni për shkelje të Kodit Doganor në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, njofton menjëherë Degën e Doganës në Rinas.

Neni 17

Dogana

17.1. Autoritetet doganore në Aeroport, si pjesë e administratës doganore e në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, përfaqësohen nga Dega Doganore Rinas e

cila operon në zonën doganore Rinas.

17.2. Dega e Doganës Rinas, është përgjegjëse për organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë doganore në Aeroport në përputhje me legjislacionin doganor dhe kërkesat e kësaj rregulloreje. Detyrat kryesore të autoriteteve doganore në Rinas janë:

a) Të sigurojë respektimin e dispozitave të përcaktuara në Kodin Doganor dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, zbatimi i të cilave u është ngarkuar autoriteteve doganore në Aeroport duke ushtruar kontroll mbi mallrat, mbi mjetet e transportit (përfshirë dhe mjetet ajrore) mbi pasagjerët dhe bagazhet e tyre, që hyjnë, dalin apo tranzitohen nga dhe në këtë aeroport e që janë nën mbikëqyrjen doganore.

b) Të kontrollojë e të inspektojë të gjitha mallrat (Cargo) dhe bagazhet e udhëtarëve, në mënyrë manuale ose nëpërmjet aparaturave të kontrollit sipas “kanalit të kuq”, si dhe të gjithë dokumentacionin doganor shoqërues, për të verifikuar nëse sasia dhe cilësia e mallrave dhe sendeve janë në përputhje me deklaratimet dhe dokumentet shoqëruese.

c) Të vjelë detyrimet e importit apo eksportit duke ushtruarin kontrollet e nevojshme për të verifikuar nëse këto detyrime janë paguar nga personi përgjegjës.

d) Të ushtrojë kontroll në mënyrë manuale ose nëpërmjet aparaturave të kontrollit sipas “kanaleve të kuq”, ose “të gjelbër” për zbulimin, parandalimin, verifikimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore, kundërvajtjeve e kontrabandës, si dhe ndaj trafikut të kundërligjshëm të “mallrave të ndaluara”, duke i kushtuar vëmendje të veçantë mallrave që rrezikojnë sigurinë publike, shëndetin e njerëzve, pasuritë kulturore kombëtare si: armët, lëndët narkotike, prodhime strategjike e të teknologjive të larta, lëndëve helmuese, parave të pista, veprave të artit me vlera kombëtare, si dhe mallrave të tjera të kësaj natyre që importimi, tranzitimi dhe eksportimi i tyre është i ndaluar apo i kufizuar me akte ligjore dhe nënligjore.

e) Të ushtrojë kontroll kur e shohin të nevojshme apo kur kanë të dhëna operative mbi pasagjerët duke i kontrolluar edhe në trup.

f) Të mbajë nën mbikëqyrje mjetet ajrore, ekuipazhet, bagazhet dhe furnizimet e tyre, si në hyrje, edhe në daljen e tyre nga territori i Republikës së Shqipërisë.

g) Të mbajë nën mbikëqyrje bagazhet që kalojnë nëpërmjet VIP-eve (përveç atyre bagazheve që me ligj nuk lejohet ushtrimi i kontrollit), mallrat që hyjnë dhe dalin në dhe nga dyqanet “Duty free Shop” (dyqane pa pengesa doganore), si dhe çdo mall, bagazh apo mjete transporti që nuk kalon në pikat e kalimit të përcaktuara me ligj.

h) Të respektojë orarin e përcaktuar për operim në Aeroport.

i) Të shkëmbejë informacionin konfidencial apo sekret që ka të bëjë me plotësimin e detyrave të lartpërmendura në këtë nen, brenda kompetencave që i jep ligji, me organet operuese në Aeroport, veçanërisht me organin e policisë.

j) Të ndihmojë organet e tjera operuese në Aeroport në realizimin e detyrave të tyre.

Neni 18

Shoqëritë ajrore shqiptare dhe të huaja

18.1. Shoqëritë ajrore shqiptare fillojnë të operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, mbasi të jenë licencuar nga Autoriteti Aeronautik Shqiptar (Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil), ndërsa shoqëritë ajrore të huaja operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit në bazë të marrëveshjeve qeveritare bilaterale në fushën e transportit ajror civil.

18.2. Shoqëritë ajrore shqiptare dhe të huaja, të linjave të rregullta apo charter, janë të detyruara të kenë miratuar në Autoritetin Aeronautik Shqiptar (Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil Shqiptar) programin e tyre të fluturimit për nga Aeroporti Ndërkombëtar i Rinasit dhe ta zbatojnë atë pa asnjë ndryshim.

18.3. Të gjitha shoqëritë ajrore shqiptare dhe të huaja që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, në përputhje dhe me ligjin nr.8310, datë 19.3.1998, “Për sigurinë e aviacionit civil”, duhet të kenë programin e sigurisë në aviacion, në përshtatje me kërkesat e programit kombëtar të sigurisë në aviacion të miratuar nga Autoriteti Aeronautik Shqiptar (DPAC).

18.4. Shoqëritë ajrore shqiptare dhe të huaja që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të

Rinasit, në programet e tyre të sigurisë duhet të specifikojnë procedurat që duhet të ndjekin për të mbrojtur pasagjerët, ekuipazhin, personelin tokësor, avionin dhe mjetet e tjera lehtësuese nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme.

Neni 19

Repartit ushtarak

19.1. Territori i repartit ushtarak përfshihet brenda territorit të Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit. Gjithë aktiviteti i repartit ushtarak që kryhet brenda këtij aeroporti bëhet duke u bazuar në marrëveshjet apo rakordimet që bëhen në sh.a. ANTA dhe sh.a. Albtransport.

19.2. Hyrje-daljet në repartin ushtarak bëhen nga vende të përcaktuara me marrëveshje të përbashkët, ndërmjet repartit ushtarak dhe sh.a. Albtransport.

19.3. Në marrëveshje dhe me subjektet e tjera që veprojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, vendos bashkëpunim për çdo situatë që mund t'i paraqitet vetë repartit ushtarak ose Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit.

Neni 20

Shërbimi i kërkim-shpëtimit (SAR)

20.1. Shërbimi i kërkim shpëtimit (SAR) është në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe është i instaluar brenda territorit të Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit.

20.2. Në përputhje me objektivat për të cilat ky shërbim është krijuar, shërbimi i kërkim-shpëtimit (SAR) është përgjegjës për fushën e kërkim-shpëtimit të aksioneve në rrezik dhe aksidenteve, duke ndihmuar dhe shpëtuar në të gjitha situatat në të cilat jeta njerëzore është në rrezik.

20.3. Për çdo rast emergjence, shërbimi i kërkim shpëtimit (SAR) bashkëpunon me Qendrën e Kontrollit të Trafikut Ajror (sh.a ANTA) për të bërë të mundur realizimin e qëllimeve të këtij shërbimi.

Neni 21

Shoqëritë postare dhe komerciale

21.1. Shoqëritë postare (DHL, Albapost etj.) veprojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, në bazë të procedurave të miratuara me sh.a. Albtransport dhe në bashkëpunim me shoqëritë ajrore e degën e doganës.

21.2. Shoqëritë komerciale (Air BP, Duty-free shop, bare-restorante chateringut etj.) veprojnë gjithashtu në bazë të marrëveshjeve përkatëse që ato kanë me sh.a. Albtransport, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe rregullat e përcaktuara nga Kodi Doganor.

21.3. Shoqëria e furnizimit me karburant Air BP, në bazë të marrëveshjes që ka me sh.a. Albtransportin, informohet për oraret e operimit të avionëve, duke organizuar furnizimin me karburant të tyre, në përputhje me rregullat e sigurisë në vendqëndrim, duke u përgjigjur për çdo thyerje të rregullave të sigurisë dhe vonesave që mund t'u shkaktojë shoqërive ajrore që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit.

PJESA E III DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22

Informimi

22.1. Për çdo akt të ndërhyrjes së paligjshme, incident apo aksident që ndodh në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, Autoriteti Aeronautik Shqiptar (DPAC) përgatit informacionin përkatës të cilin ia dërgon nëpërmjet Ministrisë së Transportit, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe kjo ia dërgon:

- a) shtetit të regjistrimit të avionit;
- b) shtetit operues të avionit;
- c) shteteve që u përkasin pasagjerët që janë prekur nga ngjarja e ndodhur;
- d) Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil Ndërkombëtar (ICAO).

22.2. Informimi përgatitet në kohë dhe dërgohet jo më vonë se 30 ditë nga dita e zhvillimit të ngjarjes.

Neni 23 Organet zbatuese

23.1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil në Ministrinë e Transportit, Drejtoria e Policisë Kufitare në Ministrinë e Rendit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Ministrinë e Financave, Komanda e Forcave të Mbrojtjes Ajrore (FAj) në Ministrinë e Mbrojtjes, sh.a. Albtransport, sh.a. ANTA dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe privatizimit.

Neni 24 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M Nr. 151, datë 22.3.2001

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 230, DATË 22.7.1991, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E KOMISIONEVE TË TOKAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 230, datë 22.7.1991 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Termet "Këshilli i rrethit", "Komiteti ekzekutiv i rrethit", "Komisioni i tokës, në rreth", "Kryetari i këshillit të rrethit", zëvendësohen përkatësisht me termet "Këshilli i qarkut", "Kryesia e këshillit të qarkut", "Komisioni i tokës, në qark", "Kryetari i këshillit të qarkut".

Termi "Kryeplaku i fshatit" zëvendësohet me termin "Kryetari i fshatit".

2. Në hyrje të vendimit, fjalët "të komisioneve të tokës në rrethe dhe fshat", zëvendësohen me fjalët "të komisioneve të tokës në qarqe, në komuna, në bashki dhe në fshatra".

3. Në kapitullin I, të Komisionit Qeveritar të Tokës, bëhen këto shtesa dhe ndryshime, me këto përmbajtje:

- Në paragrafin e tretë, pas fjalëve "në këshillat e qarqeve" shtohen fjalët "në komuna dhe në bashki".

- Në paragrafin e katërt, pas fjalëve "për kufijtë e tokës" shtohen fjalët "bujqësore, ndërmjet nënndarjeve brenda qarkut, kur ajo nuk arrihet nga komisioni i tokës, së qarkut".

- Në fund të paragrafit, fjalët "për punën e bërë nga komisioni i rrethit dhe ai i fshatit" zëvendësohen me fjalët "për punën e bërë nga komisioni i tokës, i qarkut, komisionet e komunave, të bashkive dhe të fshatrave".

- Në fund të paragrafit të pestë, i cili trajton përgjegjësitë e Komisionit Qeveritar, shtohet fjalia "Çështjet, për shqyrtim në komision, i paraqet sekretari dhe grupi pranë Komisionit Qeveritar të Tokës".

- Fjalët "Thërret në mbledhjet e tij drejtuesit e komitetit ekzekutiv të rrethit dhe të komisionit të tokës, në rreth", ndryshohen si vijon: "Thërret në mbledhjet e tij drejtuesit e komisioneve të tokës, të qarkut dhe kur e gjykon të nevojshme edhe drejtuesit e komisioneve të komunave dhe të bashkive."

4. Në kapitullin II, të komisionit të tokës në qark, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Pas pikës së parë shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Përbërja e komisionit të tokës në qark, miratohet me vendim të këshillit të qarkut. Në përbërje të komisionit, nga nënndarjet e qarkut, të jenë drejtorët e bujqësisë dhe ushqimit, përgjegjësit e kadastrës, përgjegjësit e zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përfaqësuesi i degës së rendit dhe deri në 10 anëtarë të tjerë, si agronomë, juristë, ekonomistë, inxhinierë gjeodet, etj, të cilët merren nga nënndarjet e qarkut, në raportet të drejta me sipërfaqen e tokës bujqësore të tyre.

Komisioni i tokës, i qarkut, i merr vendimet kolegjisht dhe quhen të miratuara, kur për to kanë votuar më tepër se 50 për qind e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të komisionit.

Komisioni i qarkut thirret në mbledhje nga kryetari, jo më rrallë se një herë në dy muaj.

Kryetarët e komisioneve të tokës, të komunave dhe bashkive, drejtorët e bujqësisë dhe të ushqimit, në bashkërendim me përgjegjësit e kadastrës, i paraqesin çështjet për shqyrtim dhe propozimet pranë sekretarit të komisionit të tokës, të qarkut. Sekretari i komisionit të tokës, të qarkut, caktohet nga drejtori i bujqësisë dhe ushqimit ku ndodhet qendra e qarkut.

Pika 2 e këtij kapitulli ndryshohet si vijon:

"2. Zgjidh mosmarrëveshjet, që kanë lindur, ndërmjet individëve dhe komisionit të tokës, në fshat, të cilat janë shqyrtuar më parë në komisionin e komunës dhe të bashkisë dhe, që janë kundërshtuar nga njëra palë ose mosmarrëveshjet, të cilat nuk janë zgjidhur e bazuar në dispozitat ligjore".

- Në pikën 4 pas fjalëve "nga komisionet e fshatit", shtohen fjalët "të komunave dhe të bashkive".

- Në fund të paragrafit të parë të pikës 8, shtohet "Shkarkimin mund ta bëjë edhe me propozimin e argumentuar të komisionit të tokës të komunës apo të bashkisë."

5. Në kapitullin II/a të komisionit të tokës në komunë, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Pas shkronjës "c" shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Vë në dijeni komisionin e tokës të qarkut, për vendimet që merr për shqyrtim dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas kriterëve ligjore."

- Në shkronjën "e/1", në vazhdim të fjalëve "kur në juridiksionin e bashkisë ka edhe fshatra ..." shtohen fjalët "apo tokë bujqësore për ndarje..."

- Paragrafi i dytë i shkronjës "g" ndryshon si vijon: "Për komisionin e qarkut dhe organe të tjera, që lidhen me ligjin për tokën, me propozimin e grupit të Komisionit Qeveritar të Tokës, vendos Kryetari i Komisionit Qeveritar të Tokës."

6. Në kapitullin III të komisionit të tokës, në fshat, bëhet kjo shtesë:

- Në pikën 6, në vijim të fjalëve "Në mbështetje të materialit të komisionit të fshatit..." shtohen fjalët "që shqyrtohet, paraprakisht, nga komisioni i tokës, i komunës dhe i bashkisë."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 152, datë 22.3.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 831, DATË 28.12.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DHËNIEN ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE, PASURI SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 15 të ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998 "Për dhënie me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 831, datë 18.12.1998, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika I.1, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit ose Drejtoria e Shërbimit Pyjor në rreth, bën studimin për tokat bujqësore ose pyjore e me bimësi pyjore, të regjistruara në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si pasuri shtetërore dhe që jepen me qira, në rrethin ku ajo shtrin juridiksionin."

2. Pika I.2 ndryshohet si vijon:

"Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit shqyrton dhe miraton studimet e paraqitura nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit në rreth, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave ato të paraqitura nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor në rreth."

3. Në titullin e vendimit, si dhe në pikat I.1, shkronjat "a", "b", "c", "e" dhe II.4, pas fjalëve "... tokë bujqësore" shtohen fjalët "pyjore dhe me bimësi pyjore."

4. Pas pikës II.3, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"Bordi i dhënies me qira të tokës, pyjore e me bimësi pyjore, përbëhet nga nëntë anëtarë, të cilët janë Drejtori i Shërbimit Pyjor në rreth, specialist pyjesh, ekonomist, agronom, specialist blegtorie, specialist i mjedisit, specialist i kadastrës, topograf dhe jurist. Kryetar i bordit është Drejtori i Shërbimit Pyjor në rreth. Krijimi i bordit bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Pyjeve dhe Kullotave."

5. Pika II.5 ndryshohet si vijon:

"Bordi i dhënies me qira të tokës bujqësore, pyjore dhe me bimësi pyjore përcakton fituesin e ankandit dhe ia paraqet atë për miratim Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit. Pas miratimit, bordi shpall fituesin dhe Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit ose Drejtoria e Shërbimit Pyjor në rreth, lidhin kontratat përkatëse."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Iir Meta

V E N D I M
Nr. 153, datë 22.3.2001

**PËR PROCEDURAT E OPERACIONEVE FINANCIARE NË ZBATIM TË
LIGJIT NR. 8030, DATË 15.11.1995 "PËR KONTRIBUTIN E SHTETIT PËR FAMILJET E
PASTREHA ", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 8647, DATË 24.7.2000**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 5 të ligjit nr. 8647, datë 24.7.2000 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8030, datë 15.11.1995" "Për kontributin e shtetit për familjet pastreha", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Normat e strehimit për sipërfaqet e banimit që do t'u takojnë familjeve të pastreha, të kategorisë emergjente, qiramarrëse në ish-pronë private, të jenë normat e përdorura në privatizimin e banesave shtetërore në vitin 1993, (4-6m² për frymë).

2. Për familjet e pastreha qiramarrëse në ish-pronë private, që kërkojnë të sigurojnë banesë nëpërmjet tregut të lirë, llogaritja e çmimit falas të bëhet sipas diferencës së vlerës së kostos së sotme të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave me tarifën e indeksuar sipas tabelës "Vlefa e tarifës së banesave në 000/lek" (korrigjuar me Indeksën e Korrigjimit të Çmimeve, ku klasifikimi i apartamentit të merret ndërtimi i ri (0 vjet) të udhëzimit nr. 1, datë 23.1.1993.

3. Familjet që përfitojnë banesë dhe që kërkojnë të sigurojnë banesë nëpërmjet tregut të lirë të paraqesin kërkesën me dokumentacionin përkatës pranë Entit Kombëtar të Banesave, brenda tremujorit të parë të çdo viti. Llogaritja të bëhet nga Enti Kombëtar i Banesave dhe likuidimi nga fondi i planifikuar nga buxheti i shtetit. Pas likuidimit të detyrimit nga Enti Kombëtar i Banesave qytetarit i hiqet statusi i të pastrehit.

4. Për banesat e ndërtuara apo të blera në tregun e lirë nga Enti Kombëtar i Banesave, subvencioni shtetëror për familjet e pastreha, do të zbriten drejtpërdrejt nga vlera e banesës, në çastin e lidhjes së kontratës përfundimtare, ndërmjet qytetarëve dhe Entit Kombëtar të Banesave dhe do t'i njihet Entit Kombëtar të Banesave si shlyerje detyrimi ndaj buxhetit të shtetit.

5. Familjet e pastreha që kanë në përbërje të tyre invalidë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ish-partizanë, luftëtarë antifashistë, që kanë marrë pjesë në formacionet antifashiste para datës 29.11.1944, duhet të paraqesin përveç të tjerave edhe dokumentin zyrtar, të lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes, në zbatim të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, ndryshuar me ligjin nr. 8526, datë 23.9.1999 "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare".

6. Organet e pushtetit vendor, nëpërmjet këshillave bashkiake ose komunave, të dërgojnë pranë Entit Kombëtar të Banesave, brenda tremujorit të parë të vitit, listën nominale të familjeve të pastreha që përfitojnë nga ligji nr. 8647, datë 23.7.2000, të cilat nuk janë trajtuar deri më sot nga Banka e Kursimeve. Listat nominale të familjeve të pastreha qiramarrëse në ish-pronë private duhet të jenë hartuar sipas përbërjes familjare dhe gjendjes së strehimit, që rezultojnë në regjistrat themeltarë të shtetasve më datë 1.12.1992.

7. Pika 1, 2, 7, 8 dhe 15 të vendimit nr. 249, datë 16.4.1996, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e operacioneve financiare për dhënien e kredive dhe të subvencioneve shtetërore, që do të kryhen nga Banka e Kursimeve, në zbatim të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha" shfuqizohen.

8. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike, Enti Kombëtar i Banesave dhe organet e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Illir Meta

V E N D I M
Nr. 156 datë 22.3.2001

PËR SHKOLLAT JOPUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. PËRCAKTIMI I KRITEREVE PËR DHËNIEN E LEJES

1. Shkollat e larta jopublike në territorin e Republikës së Shqipërisë veprojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

2. Shkollat e larta jopublike mund të jenë të nivelit jouniversitar, universitar dhe pasuniversitar.

3. Procesi i dhënies së lejes për shkollat e larta jopublike përfshin dy faza:

a) Dhënien e lejes, e cila jep të drejtën e hapjes dhe të fillimit të procesit mësimor;

b) Akreditimin, i cili bën të mundur njohjen e kursit të studimit dhe të shkollës.

4. Leja shtetërore për funksionimin e shkollave të larta jopublike dhe mbyllja e tyre, bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të propozimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

5. Subjekti që dëshiron të hapë një shkollë të lartë jopublike, për marrjen e lejes, duhet të paraqesë një kërkesë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, e cila duhet të shoqërohet me këto dokumente:

a) vendimin e Gjykatës së Faktit për regjistrimin si person juridik;

b) aktin e themelimit;

c) emrin, vendndodhjen, një kopje të dokumenteve të regjistrimit dhe të licencës së mësimin të vendit nga vjen (në qoftë se enti financues është person juridik, i huaj) dhe tipin e shkollës së lartë jopublike që kërkon të hapë (sipas nenit 2 të këtij vendimi);

ç) statutin, i cili duhet të përmbajë: emrin e plotë të shkollës së lartë jopublike, adresën, tipin, qëllimin dhe zgjatjen e procesit mësimor, gjuhën e zhvillimit të mësimin, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, financimin dhe veprimtarinë ekonomike, procedurat për pranimin dhe diplomimin e studentëve, të drejtat dhe detyrat e studentëve, kriteret për punësim, normën mësimore-shkencore, kohën e punës dhe të pushimit, marrëdhëniet me shkollat e larta, të drejtat dhe detyrat e personelit;

d) rregulloren e brendshme, e cila duhet të përmbajë: dispozitat e përgjithshme, strukturën organizative, format e organizimit të studimeve dhe të kontrollit të dijeve, diplomimin, të drejtat dhe detyrimet e studentit e të pedagogut, standartet etike;

dh) të dhënat rreth kursit të studimit, të cilat duhet të jenë në përputhje me standardet e hartuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;

e) listat e plota të personelit drejtues, të personelit akademik (të brendshëm dhe të jashtëm), të personelit ndihmës mësimor-shkencor, të personelit administrativ, së bashku me disa gjeneralitete: datëlindja dhe vendlindja, kombësia dhe shtetësia, arsimimi, specialiteti diploma dhe kualifikime të tjera të dokumentuara, detyra funksionale në institucion, dëshmia e penaltetit;

ë) një katalog me listën e vendeve të punës dhe me kërkesat për çdo vend pune;

f) planin afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit institucional;

g) dokumentet që vërtetojnë garancinë financiare për financimin e personelit dhe të të gjitha veprimtarive mësimore-shkencore të shkollës së lartë jopublike për një cikël të plotë për çdo kurs studimi. Dokumenti i garancisë financiare duhet të paraqitet çdo vit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

gj) deklaratën në të cilën subjekti angazhohet të sigurojë një dokument pronësie apo kontratë qiraje për ndërtesën në të cilën do të funksionojë shkolla e lartë jopublike. Dokumenti i pronësisë

ose kontrata e qirasë duhet të realizohet jo më vonë se tre muaj para fillimit të vitit akademik shkollor. Në rastin e kontratës së qirasë, afati i saj duhet të jetë sa zgjatja e kursit mësimor;

h) vërtetimin nga inspektorati sanitar për konfirmimin që mjedisi i plotëson kushtet higjieno-sanitare, pasi është siguruar dokumenti i pronësisë ose kontrata e qirasë;

i) dokumentin e identifikimit të subjektit juridik, si person i tatueshëm, si dhe vërtetimin nga dega e tatim-taksave;

j) autorizimin nga zyra e punës të rrethit përkatës ku ushtrohet veprimtaria, si dhe nga Inspektorati i Punës.

6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të verifikojë gjendjen e objektit, jo më vonë se tri javë para fillimit të procesit mësimor. Për rregullimin e mangësive të vërejtura ajo vendos afate dhe/ose pezullon fillimin e procesit mësimor deri në plotësimin e tyre.

7. Nëse Ministria e Arsimit dhe Shkencës vëren pamjaftueshmëri në kërkesat e pikës 5, ajo fton subjektin juridik t'i eliminojë ato brenda një muaji. Kur subjekti juridik dështon në eliminimin e mungesave, brenda afatit të caktuar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës i ndërpret procedurat e filluara. Ministria e Arsimit dhe Shkencës merr vendim në bazë të të dhënave origjinale ose të noterizuara.

8. Për vlerësimin e kërkesës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës krijon një komision të posaçëm, të përbërë nga përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit të lartë, të drejtorisë së investimeve, të drejtorisë Ekonomike, të Sektorit Juridik, të Agjencisë së Vlerësimit dhe Akreditimit. Komisioni drejtohet nga Zëvendësministri, i cili mbulon arsimin e lartë.

Kur shkolla e lartë jopublike ose enti financues i shkollës së lartë jopublike është subjekti i huaj, pavarësisht nga kombësia e subjektit përfaqësues në territorin e Republikës së Shqipërisë, përpara vlerësimit të kërkesës nga komisioni i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, merret edhe mendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

9. Leja e funksionimit nuk jepet në rastet kur:

a) Ministria e Arsimit dhe Shkencës shprehet negativisht për kërkesat e pikës 5.

b) doklumentacioni i paraqitur nuk plotëson standardet e vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për programin e studimeve dhe për zhvillimin e veprimtarive mësimore, kualifikuese, shkencore, krijuese, artistike etj.

c) përshkrimi i rregullave të brendshme nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të Republikës së Shqipërisë.

10. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nëpërmjet procesit të akreditimit bën procesin e vlerësimit dhe të akreditimit, i cili jep të drejtën e njohjes së kursit të studimit dhe të shkollës së arsimit të lartë jopublik, brenda 5 vjetësh pas marrjes së lejes dhe para përfundimit të kursit të studimit. Rezultatet bëhen publike.

11. Shkolla e lartë jopublike paraqet në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në fund të çdo viti akademik, raportin e detajuar për veprimtarinë e saj mësimore – shkencore të zhvilluar.

12. Shkollat e larta unviersitare jopublike kanë të drejtë të realizojnë aspektet e të arsimit pasuniversitar, në mbështetje të legjisalcionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Arsimi pasuniversitar përfshin kualifikimin shkencor pasuniversitar, kurset e specializimit dhe kurset e kualifikimit afatshkurtër e afatgjatë.

13. Hapja dhe funksionimi i arsimit pasuniversitar nga shkollat e larta jopublike bëhet me miratimin e Këshillit të Ministrave, mbi bazën e propozimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, sipas projekteve të propozuara nga një shkollë e lartë unviersitare jopublike, vetëm ose në bashkëpunim me një ose disa shkolla të larta unviersitare, publike ose jopublike, duke respektuar procedurat e pikës 2.

14. Projekti që i propozohet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për zhvillimin e arsimit pasuniversitar, duhet të jetë i miratuar nga organi më i lartë drejtues i shkollës së lartë jopublike dhe të jetë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

II. PËRCAKTIMI I KRITEREVE TË FINANCIMIT, TË INVESTIMEVE DHE TË INFRASTRUKTURËS SË SHKOLLAVE TË LARTA JOPUBLIKE

1. Shkollat e larta jopublike duhet të paraqesin burimet e veta financiare.
2. Shteti nuk merr përsipër asnjë lloj financimi, shpenzimi apo detyrimi për shkollat e larta jopublike dhe për studentët e këtyre shkollave.
3. Kostoja e shpenzimeve të llogaritura, për studentët e shkollave të arsimit të lartë jopublik, duhet të jetë e specifikuar dhe të mos jetë nën kufirin e kostos së shpenzimeve të studentëve të shkollave të larta publike, të evidentuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
4. Në rastet kur Këshilli i Ministrave vendos tërheqjen e lejes së shkollës së lartë jopublike (pikat 1/a, 1/c, 1/ç, 1/d, 1/dh të kapitullit IV), shkolla e lartë jopublike i kthen studentëve kontributin e tyre financiar që ata i kanë paguar shkollës për arsimimin e tyre në atë shkollë.
5. Shkolla e lartë jopublike ka të drejtë të pranojë ndihma financiare që lidhen me objektin e veprimtarisë së vet në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

III. DETYRIME TË TJERA TË SHKOLLËS SË LARTË JOPUBLIKE

1. Një shkollë e lartë jopublike është e detyruar:
 - a) të publikojë rezultatet e vlerësimit dhe të akreditimit;
 - b) të njoftojë Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për çdo shmangie dhe anomali në funksionimin normal të saj;
 - c) të njoftojë Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për mbylljen e saj, jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të vitit akademik.
 - ç) vetëm në rastin kur shkolla e lartë jopublike mbyllet pa përfunduar ciklin e plotë të studimeve, studentët e saj, që kanë kryer më shumë se gjysmën e ciklit të studimeve, mund t'i vazhdojnë studimet në shkollat e larta publike ose jopublike, pasi të kenë kryer procesin e ekuivalentimit të programit të realizuar.

Për pranimin e kësaj kategorie studentësh, shkollat e larta publike, në përputhje me masën e ekuivalentimit të programeve dhe të kapaciteteve të tyre, mund t'i pranojnë këta studentë vetëm në kuotat dytësore.

IV. FUSHA E AUTORITETIT TË MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës i propozon Këshillit të Ministrave tërheqjen e lejes për shkollën e lartë jopublike, në këto raste:
 - a) Veprimtaria e shkollës së lartë jopublike shmanget nga objekti i miratuar;
 - b) Nuk arrihet akreditimi i kursit të studimeve;
 - c) Shkolla e lartë jopublike, gjatë funksionimit, nuk i përmbahet kërkesave të këtij vendimi;
 - ç) Veprimtaria e shkollës së lartë jopublike nuk i përgjigjet statutit dhe rregullores së miratuar dhe nuk kryen në kohë korrigjimet e nevojshme, të kërkuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës ose të lëna si detyrë nga inspektimet e paralajmëruara;
 - d) Leja bëhet e pavlefshme në rastet kur shkolla e lartë jopublike nuk fillon veprimtarinë mësimore-shkencore, jo më vonë se viti akademik pasardhës;
 - dh) Shkolla e lartë jopublike përfundon pa paralajmërim ciklin e studimeve.
2. Tërheqja e lejes bëhet publike.
3. Shkolla e lartë jopublike nuk vazhdon të veprojë si e tilë me heqjen e lejes.
4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pas dhënies së lejes, kryen inspektime të paralajmëruara në shkollën e lartë jopublike.
5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës është përgjegjëse për standardet e veprimtarisë mësimore, kërkimore e kualifikuese të shkollës së lartë jopublike.
6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 167, datë 30.3.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE"

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në paragrafin e parë të pikës 19 bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

"- Profesor, drejtues kërkimesh	54 450 lekë
- Profesor i asociuar, mjeshtër kërkimesh	45 980 lekë
-Pedagog me gradë shkencore	31 460 lekë".

2. Paragrafi i dytë i pikës 19 ndryshohet si vijon:

"Kur këta punonjës caktohen në funksione drejtuese, përveç pagës përkatëse, marrin edhe shtesën në përqindje mbi këtë pagë si vijon:

- Rektor i universitetit të kategorisë së parë	25 për qind
- Zëvendësrektor i universitetit të kategorisë I	
Rektor i universitetit të kategorisë II	20 për qind

3. Në lidhjen 1 "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit," bëhen këto ndryshime:

- Në klasifikimin B2, shtohet emërtimi "Profesor, drejtues kërkimesh" dhe shfuqizohet kjo emërtesë në klasifikimin B4.

- Në klasifikimin B3, shtohet emërtimi "Profesor i asociuar, mjeshtër kërkimesh".

- Në klasifikimin B5, shfuqizohet emërtimi "Profesor i asociuar, mjeshtër kërkimesh dhe shtohet emërtimi "Pedagog me gradë shkencore".

Në klasifikimin C2, shtohet emërtimi "Pedagog"

Në klasifikimin C3, shtohet emërtimi "Asistent".

4. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në buxhetin e vitit 2001, i shtohet fondi prej 80 000 000 lekësh, për të përballuar efektet financiare të këtij vendimi.

Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 maj 2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 221 datë 13.4.2001

**PËR ADMINISTRIMIN DHE SHITJEN E MALLRAVE TË KONFISKUARA NË
MBËSHTETJE TË LIGJIT NR. 8717, DATË 15.12.2000 "PËR VENDOSJEN E PULLAVE
NË ARTIKUJT E DUHANIT E TË PIJEVE ALKOOLIKE"**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 dhe 5, të ligjit nr. 8717, datë 15.12.2000 "Për vendosjen e pullave në artikujt e duhanit e të pijeve alkoolike", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Mallrat e konfiskuara nga organet shtetërore i kalojnë për ruajtje dhe administrim Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit dhe depozitohen në depot ose magazinat e kësaj Drejtorie e të degëve të saj në rrethe, pasi të jenë kryer veprimet e nevojshme për konstatimin e shkeljes.

2. Shitja e këtyre mallrave, nëse vërehet vepra penale e kontrabandës, do të bëhet sipas kritereve të këtij vendimi, pasi të jetë marrë miratimi i organit të prokurorisë.

3. Mallrat e konfiskuara shoqërohen nga personat, që kanë vënë re shkeljen dhe njëkohësisht nga forcat e policisë së rendit, kur kjo është e domosdoshne për kushtet e kryerjes së transportimit.

4. Mallrat që janë jashtë çdo mundësie transportimi a magazinimi, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit ose degëve të saj, në rrethe, vlerësohen mallra në ruajtje dhe administrohen prej kësaj Drejtorie, e cila, për këto raste, autorizohet të nënshkruajë kontrata me persona juridikë për lënien e këtyre mallrave, përkohësisht, në ruajtjen e tyre.

5. Dorëzimi i mallrave të konfiskuara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit apo degëve të saj në rrethe bëhet me dokumentacion të rregullt dhe në bazë të procesverbalit të mbajtur nga dorëzuesi dhe pranuesi i mallit. Drejtorja e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit të çojë në organet e specializuara mallrat e konfiskuara, brenda tri ditëve, për konfirmim të treguesve të radioaktivitetit dhe të treguesve të tjerë cilësorë dhe në rastet e mallrave të cilat, në bazë të analizave të kryera nga organet e specializuara, kjo Drejtori kryen asgjësimin e tyre.

6. Organet e Ministrisë së Rendit Publik dhe ato të Ministrisë së Mbrojtjes janë të detyruara të vënë në dispozicion forcat e tyre, me kërkesën e parë, me shkrim, të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, për ruajtjen e objekteve, në të cilat janë depozituar mallrat e konfiskuara.

7. Mallrat e konfiskuara nga organet shtetërore, të cilat janë në ruajtje dhe administrim, në magazinat e rezervave të shtetit, shiten sipas parashikimeve të këtij vendimi nga Drejtorja e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit ose nga degët e saj në rrethe dhe të ardhurat, pasi të jenë zbritur shpenzimet e magazinimit, ruajtjes, administrimit, pullosjes dhe shitjes, kalojnë në favor të buxhetit të shtetit. Ministria e Financave bën kalimin e shumave, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 296 të ligjit nr. 8449, datë 27.1.2000 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

8. Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, përveç shpenzimeve të saj për ruajtjen, administrimin, pullosjen dhe shitjen e mallrave, i jepet dhe një shumë prej 2 për qind e çmimit përfundimtar të ankandit. Një shumë prej 2 për qind i jepet edhe Prokurorisë së Përgjithshme.

9. Ministria e Financave të marrë masat për prodhimin e pullës adezive fiskale. Kjo pullë të jetë e njëjtë për të gjithë artikujt e duhanit dhe për të gjithë artikujt e pijeve alkoolike dhe të pajisë Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave të Shtetit me pullën adezive fiskale, sipas kërkesave të kësaj të fundit.

10. Shitja e mallrave të konfiskuara bëhet sipas procedurave të ankandit, të përcaktuara në këtë vendim.

11. Çmimi i shitjes së mallit të jetë jo më i vogël se detyrimet fiskale për atë mall, e caktuar kjo në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.

12. Ankandi të zhvillohet pas 15 ditëve nga data e shpalljes së tij, si dhe pas kryerjes së veprimeve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

13. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit ose degët e saj, në rrethe, të publikojnë për dy ditë të njëpasnjëshme në mediat elektronike, si dhe në dy gazeta me tirazh të madh, të dhënat për ankandin. Në njoftim duhet të jenë të specifikuar kryesisht lloji i mallit, sasia, çmimi fillestar i ankandit, vendi, data dhe ora e zhvillimit të ankandit.

14. Në ankand lejohet të marrin pjesë gjithë personat, fizikë a juridik, që kanë cilësinë e tregtarit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që kanë depozituar si garanci në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit një vlerë monetare të barabartë me 10 për qind të çmimit fillestar të ankandit.

15. Komisioni i Ankandit krijohet me urdhër të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit ose të degëve të saj, në rrethe. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë. Shpërblimi i anëtarëve të komisionit të ankandit caktohet nga titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit dhe shpenzimet për këtë pagesë përballohen nga fondi i përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, sipas pikës 8 të këtij vendimi.

16. Fituesi i këtij ankandi duhet të paguajë çmimin e ofruar prej tij, brenda 5 ditëve nga data e mbylljes së ankandit, në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit. Në rast se ky çmim nuk është paguar sipas parashikimit të kësaj pike, malli i jepet personit që ka ofruar çmimin e dytë më të lartë në ankand dhe fituesit të ankandit i konfiskohet garancia 10 për qind, e parashikuar në pikën 14 të këtij vendimi.

17. Dorëzimi i mallit, personit fitues të ankandit, bëhet vetëm pasi, në organin që ka zhvilluar ankandin të jetë paraqitur dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës, sipas parashikimeve të pikës 16 të këtij vendimi, si dhe pasi të jetë ngjitur pulla fiskale në çdo paketë cigare, mbi kapak të çdo shisheje me pije alkoolike apo ambalazhim të llojit tjetër të pijeve alkoolike.

18. Në rast se në ankand nuk merr pjesë asnjë subjekt ose kur malli nuk tërhiqet nga personat fitues, të parashikuar sipas pikës 16 të këtij vendimi, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit apo degët e saj në rrethe rifillojnë menjëherë procedurën e ankandit.

Vendimi nr.598, datë 30.12.1997, i Këshillit të Ministrave, "Për administrimin dhe shitjen e mallrave të konfiskuara në bazë të ligjit nr.8262, datë 15.12.1997 "Për vendosjen e pullave në artikujt e duhanit dhe të pijeve alkoolike dhe për ngjyrosjen e nënprodukteve të naftës", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M

Nr.223, datë 13.4.2001

PËR VLERËSIMIN CILËSOR TË MARKAVE TË CIGAREVE TË PRANISHME NË TREGUN SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15, të ligjit nr.8691, datë 16.11.2000 "Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve" dhe të nenit 3, të ligjit nr.8716, datë 15.12.2000 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8437, datë 28.12.1998 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Prodhuesit dhe importuesit e produkteve të duhanit, regjistrojnë markat e tyre në regjistrin e markave, në Agjencinë Kombëtare të Duhan-Cigareve.
2. Regjistri i markave përmban të dhëna për:

- a) personin, fizik/juridik, prodhues ose importues të produkteve të duhanit;
- b) emërtimin tregtar, të produkteve të duhanit të prodhuar apo importuar;
- c) treguesit fiziko-kimikë të produkteve të duhanit;
- ç) treguesit shijorë të produktit të duhanit;
- d) të dhëna për kategorinë e produktit të duhanit.

3. Përcaktimi i treguesve fiziko-kimikë dhe kondensatit të tymit të duhanit dhe të produkteve të duhanit, bëhet në Institutin e Kërkimeve Ushqimore, sipas standardeve shqiptare dhe atyre të Organizatës Ndërkombëtare të Standardeve (ISO).

4. Vlerësimi cilësor i të gjitha markave të produktit të duhanit, të pranishme në tregun shqiptar, bëhet nga komisioni i specialistëve të degustimit. Anëtarët e këtij komisioni zgjidhen sipas këtyre kriterëve:

- Të jetë duhanpirës.
- Të jetë specialist i lartë dhe të ketë përvojë pune, mbi 5 vjet, në industrinë ushqimore.
- Të ketë njohuri për lidhjen ndërmjet përbërjes së harmaneve, treguesve fiziko-kimikë dhe lidhjes së tyre me treguesit degustativë.

Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, të cilët janë përfaqësues të:

- Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;
- Ministrisë së Financave;
- Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë (sektori i mbrojtjes së konsumatorit);
- Institutit të Kërkimeve Ushqimore;
- Institutit të Duhanit, Cërrik;
- Shoqatës së Industrialistëve të Duhanit;
- Fabrikave të duhan-cigareve dhe specialistë me përvojë në fushën e prodhimit të cigareve.

Propozimet emërore bëhen nga institucionet e mësipërme dhe miratohen nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, i cili emëron edhe kryetarin e këtij komisioni. Anëtarët e komisionit zëvendësohen, çdo 2 vjet, me anëtarë të rinj. Çdo ndryshim në përbërjen e komisionit gjatë funksionimit, miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

5. Komisioni, në mbledhjen e tij të parë njihet me dokumentet përkatëse zyrtare, udhëzimet, rregulloret, procedurat e funksionimit dhe zgjedh sekretarin e komisionit.

6. Komisioni ka për detyrë:

- të kryejë vlerësimin cilësor të të gjitha markave të cigareve, të pranishme në tregun shqiptar, bazuar në mostrat e sjella nga subjekti;
- të përcaktojë vetitë shijore dhe t'i interpretojë ato;
- të bëjë kategorizimin e markave të cigareve;
- të bëjë, çdo 6 muaj, rivlerësimin e markave të cigareve dhe krahasimin e tyre, me mostrën e miratuar;
- të organizojë degustimin e fshehtë. Markat e cigareve mbulohen dhe mostrat kodifikohen.

7. Në një seancë degustimi, të degustohen deri me 4 mostra cigaresh. Kriteret e vlerësimit të treguesve shijorë të markave të cigareve, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministrisë së Financave.

8. Vendimi i komisionit i shoqëruar me analizat fiziko-kimike dhe të kondensatit të tymit, u bëhen të ditur subjekteve të interesuara dhe Ministrisë së Financave. Procedurat dhe vendimet e këtij komisioni, arkivohen në zyrën e arkiv-protokollit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

9. Shpenzimet për kryerjen e degustimit, pagesa e anëtarëve të komisionit dhe tarifat e analizave kimiko-fizike e të kondensatit të tymit, përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe të Ministrisë së Financave dhe mbulohen nga subjektet e interesuara.

10. Ministria e Financave njofton të gjitha subjektet, importuese dhe prodhuese të cigareve, për të bërë regjistrimin e markave të cigareve, që prodhojnë apo importojnë, në Agjencinë Kombëtare të Duhan-Cigareve.

11. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
NR.224, datë 13.4.2001

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE
TË DUHAN -CIGAREVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve, si institucion, shtetëror me statusin e personit juridik, publik, pa qëllim fitimi, që financohet nga buxheti i shtetit, në varësi të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, me qendër në Tiranë.

2. Numri i punonjësve të Agjencisë për vitin 2001, të jetë 10 (dhjetë) vetë, 1 (një) drejtor, 7 (shtatë) specialistë dhe 2 (dy) punonjës ndihmës.

3. Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Duhan Cigareve emërohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

4. Specialistët dhe punonjësit ndihmës emërohen nga Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Duhan- Cigareve.

5. Paga e Drejtorit të Agjencisë të jetë sipas klasifikimit B3 të lidhjes I, të vendimit nr. 726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.”, ndërsa pagat e punonjësve të tjerë të jenë sipas lidhjes II-5, “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore” të po këtij vendimi.

Rregullat e hollësishme të strukturës, të numrit organik dhe të veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Duhan –Cigareve parashikohen në rregulloren e saj, e cila miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

6. Agjencia Kombëtare e Duhan- Cigareve ka për detyrë :

të ndjekë zbatimin dhe monitorimin e ligjit nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, në të gjitha aspektet e prodhimit, industrializimit, marketimit dhe tregtimit të duhanit dhe të produkteve të tij;

të mbështesë e të zbatojë politikat e qeverisë për zhvillimin e sektorit të duhanit dhe të produkteve të tij në Shqipëri;

të përcaktojë dhe të ndjekë zbatimin e standardeve që lidhen me duhanin dhe produktet e tij;

ç. të stimulojë prodhimin dhe eksportin e duhanit;

d. t’i propozojë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, çdo vit, në fund të muajit tetor, masat që duhen marrë për sezonin e ardhshëm të kultivimit të duhanit;

dh. të propozojë kriteret për kultivimin, rajonizimin dhe strukturën varietore të duhanit;

e. të përgatisë dhe të botojë broshura për prodhimin, farërat, teknologjitë e kultivimit, strukturën varietore, industrializimin dhe tregtimin e duhanit dhe të produkteve të tij.

7. Me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit përcaktohet mënyra e administrimit të mjeteve të fondit duhan.

8. Fondi duhan përdoret për :

-zhvillimin e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Duhan–Cigareve;

prodhimin e farës së duhanit nga Instituti i Duhanit, Cërrik, për dhënien e saj falas kultivuesve të duhanit.

-kryerjen e analizave të farërave dhe të materialeve duhanore;

ç. kryerjen e studimeve për rajonizimin e duhanit në shkallë vendi, në përputhje me kërkesat e industrisë përpunuese dhe të tregut;

d. nxitjen e punës kërkimore-shkencore, për krijimin e kultivarëve dhe të hibrideve të rinj, me qëllim përmirësimin e strukturës varietore në varësi të kërkesave të industrisë përpunuese dhe të tregut.

dh. studime, sipas politikave të caktuara të qeverisë, për zhvillimin e sektorit të duhanit dhe të produkteve të tij;

e. botime, seminare, simpoziume dhe veprimtari të tjera, që zhvillohen për duhanin dhe për produktet e tij, brenda dhe jashtë vendit.

9. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

U D H Ë Z I M
Nr.19, datë 24.03.2001

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN E KQZ NR.18 DATË 11.03.2001

Punonjësit e Zyrave të Gjendjes Civile (ZGJC) do të bëjnë rishikimin edhe të formularit nr.3 (shitesë).

Formulari Nr.3 (shitesë me ngjyrë të bardhë)

Do të përdoret për të përcaktuar personat zgjedhës që janë larguar me banim nga ajo njësi administrative në një njësi tjetër administrative, personat që kanë vdekur, ata që kanë ndërruar shtetësinë nga shqiptare në një shtetësi tjetër, për të korrigjuar gabimet ortografike të emrit, mbiemrit, datëlindjes, gjinisë, si dhe të plotësojnë atësinë e personave zgjedhës që ndodhen në formularin nr.3 (shitesë).

MËNYRA E PLOTËSIMIT TË FORMULARIT.

Nëpunësi i ZGJC-së për zgjedhësit që ndodhen në formularin Nr.3 (shitesë) dhe në regjistrin e ZGJC plotëson në kolonën nr.4 atësinë p.sh: atësia (HASAN).

Për zgjedhësit që ndodhen në formularin nr.3 (shitesë) dhe që në Regjistrin e ZGJC-së figurojnë të vdekur, në kolonën e fundit të formularit, shënojmë germën D.

Për zgjedhësit që ndodhen në formularin Nr.3 (shitesë) dhe që në regjistrin e ZGJC-së figurojnë që kanë ndërruar shtetësinë nga shqiptare në një shtetësi tjetër, në kolonën e fundit të formularit shënojmë germën S.

Nëpunësi i Gjendjes Civile për çdo zgjedhës të përfshirë në formularin nr.3 (shitesë) në bazë të emrit, të regjistrit dhe numrit të faqes së tij do të kontrollojë, nëse emri, atësia, mbiemri, datëlindja dhe gjinia e zgjedhësit janë shkruar pa gabime.

N.q.s ato janë shkruar me gabime atëhere në hapësirën boshe poshtë tyre, shkruhet: emri, atësia, mbiemri, datëlindja apo gjinia e saktë e zgjedhësit.

Formularët nr.3 (shitesë) të plotësuar në këtë mënyrë, kalohen në zyrat e bashkisë, komunës, njësisë bashkiake. Kryetari, si dhe sekretari i keshillit të bashkisë, komunës, njësisë bashkiake do të plotësojnë (duke u nisur nga adresat e personave) numrin e qendrës së votimit të këtyre personave.

Koha e plotësimit dhe e dorëzimit të formularit nr.3 (shitesë) 25 mars – 7 prill 2001.

Shënim: Formularët nr.3 (shitesë) do të firmosen faqe më faqe nga përgjegjësi i ZGJC-së dhe sekretari i këshillit të bashkisë, komunës, njësisë bashkiake. Ky formular do të përcillet me shkresë përcjellëse, me firmë e vulë nga kryetari i bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për në KQZ.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

U D H Ë Z I M
Nr.20, datë 27.03.2001.

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN E KQZ NR.18, DATË 11.03.2001

Nga vrojtimet e bëra në disa ZGJC të Tiranës është konstatuar se ka disa parregullesi nga ana e QIF-it në lidhje me emërtimin e regjistrave. Lidhur me këtë udhëzojmë:

Nëpunësit e ZGJC-ve do të zbatojnë rigorozisht udhëzimin nr.18 dt.11.03.2001 për plotësimin e formularit nr.3, duke mos bërë asnjë veprim jashtë këtyre udhëzimeve. Për të gjitha rekordet, që nuk u përputhet emërtimi i regjistrit të formularit nr.3 të dërguar me atë ekzistues të ZGJC-ve, këto rekorde do të kërkohen në regjistrat e ZGJC-ve me indeksin që kanë këto zyra. Psh: Në formularin nr.3 të dërguar, disa rekorde emërtimin e regjistrit e kanë "KARL GEGA", në fakt ai i përket regjistrit me emërtim "KONGRESI I PERMETIT", pra duke hapur regjistrin "KARL GEGA", këto rekorde nuk gjenden aty, për këtë nëpunësit e ZGJC-ve do t'i kërkojnë me indeks, sepse këto rekorde janë të kësaj ZGJC-ve dhe nuk do të veprohet si në ndonjë ZGJC që këtyre rekordeve u kanë hequr vizë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

UDHËZIM
Nr.21 datë 05.04. 2001

**PËR VENDOSJEN E KOPJEVE ORIGJINALE TË TABELAVE, PROCES-VERBALEVE
DHE VULËS SË KQV NË KUTINË E VOTIMIT QË PËRMBAN FLETËT E VOTIMIT PËR
DEPUTET NË ZONËN NJËMËRORE**

Në bazë të nenit 106 pika 6 e ligjit nr.8609, datë 08.05.2001 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", KQV-ja pas numërimit të fletëve të votimit, për deputet të drejtpërdrejtë në zonën njëmërore, zarfet me fletët e votimit i fut në kutinë e votimit, të cilën e vendos mënjanë. Mbi bazën e fletëve të votimit të numëruara plotësohet "Tabela e Rezultateve të Qendrës së Votimit Nr. _____, për deputet të drejtpërdrejtë në Zonën Zgjedhore Nr. _____" (Modeli 54).

Pas kësaj, përsëriten procedurat e numërimit të fletëve të votimit për deputet me lista shumemërore dhe më pas plotësohet "Tabela e Rezultateve të Qendrës së Votimit Nr. _____ të Zonës Zgjedhore Nr. _____ për deputet me lista shumemërore" (Modeli 55).

Pas plotësimit të tabelave Model 54 dhe 55, kryetari i KQV-së plotëson "Tabelën e Përgjithshme të Rezultateve të Qendrës së Votimit Nr. _____ të Zonës Zgjedhore Nr. _____", e cila përmbledh të dhënat e dy tabelave të mësipërme, Modelet 54 dhe 55.

Kopjet origjinale të tre tabelave (Modelet 54, 55 dhe 56), procesverbalet dhe vula e KQV-së vendosen në kutinë e votimit që përmban fletët e votimit për deputet të drejtpërdrejtë të zonës

njëemërore. Një kopje e plotësuar e Tabelës së Përgjithshme të Rezultateve të Qendrës së Votimit (Modeli 56) vendoset në një zarf të posaçëm, i cili nuk vendoset në kutinë e votimit.

Dy kutitë e votimit vulozen me vulat jeshile dhe numrat identifikues të vulave regjistrohen në procesverbal.

Kryetari dhe sekretari i KQV-së i dorëzojnë KZZ-së përkatëse, brenda 24 orëve nga mbyllja e votimit, kutitë e votimit dhe zarfin me procesverbalet e votimit.

KZZ-ja i lëshon kryetarit të KQV-së një procesverbal dorëzimi.

Shënim: Asnjë material tjetër zgjedhor nuk futet në kutitë e votimit.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

UDHËZIM
Nr.22, datë 9.4.2001

PËR CAKTIMIN E VËZHguesVE PRANË QENDRAVE TË VOTIMIT DHE
KOMISIONEVE ZGJEDHORE

Në mbështetje të nenit 14, 15 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, udhëzon:

- Vëzhgues pranë qendrave të votimit dhe komisioneve zgjedhore mund të caktojnë organizatat joqeveritare shqiptare e të huaja të specializuara dhe të angazhuara në mbrojtjen e të drejtave të njeriut (më tej të quajtura “organizma”).

- Vëzhgues vendas mund të jetë çdo shtetas shqiptar që plotëson kushtet për të qenë zgjedhës (të jetë mbi 18 vjeç dhe të mos jetë shpallur me vendim gjykatë si i pazoti për të vepruar për shkak të paaftësisë mendore). Organizmi që kërkon të caktojë vëzhgues, përgjigjet për plotësimin e kushteve të mësipërme.

- Lista e personave që propozohen për vëzhgues nga një organizëm vendas, duhet të përmbajë adresën e organizmit që propozon vëzhgues, numrin e telefonit, informacione të tjera të dobishme për kontaktimin e subjektit dhe për çdo kandidat për vëzhgues të dhënat e mëposhtme:

EmriMbiemriDatëlindjaAtributi

(Afatgjatë, afatshkurtër)

- Lista për vëzhguesit vendas dorëzohet e shoqëruar nga dokumenti i regjistrimit të organizmit në gjykatë (fotokopje e noterizuar) dhe një kërkesë zyrtare, nënshkruar nga drejtuesi i organizmit.

- Vëzhguesit afatgjatë kanë të drejtë të vëzhgojnë procesin parazgjedhor si dhe atë paszgjedhor. Vëzhguesit afatshkurtër vëzhgojnë procesin vetëm ditën e votimit.

- Listat do të pranohen nga KQZ-ja jo më vonë se shtatë ditë para datës së zgjedhjeve.

- KQZ-ja miraton listat e vëzhguesve të paraqitura dhe pajis me autorizim të gjithë vëzhguesit, jo më vonë se 4 ditë para datës së zgjedhjeve.

- Vëzhguesit pajisen nga KQZ-ja me kartën e vëzhguesit dhe një autorizim të posaçëm. Organizmave u vihet në dispozicion një kopje e këtij udhëzimi dhe ata vetë ua bëjnë të njohur vëzhguesve të tyre.

- Vëzhguesit janë të detyruar të respektojnë kërkesat e “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” dhe udhëzimet e nxjerra nga KQZ-ja lidhur me vëzhgimin e zgjedhjeve. Ata duhet të veprojnë në mënyrë të paanshme, të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat apo parti në qendrat e votimit ose vende të tjera të ndaluara nga “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe të mos mbajnë shenja dalluese që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e

zgjedhësve. Atyre u ndalohe të ndërhyjnë në veprimtarinë e komisioneve zgjedhore.

- Në rast se KZZ-të ose KQV-të konstatojnë parregullsi në veprimtarinë e vëzhguesve, ato denoncojnë faktin pranë KQZ-së, i cili nga ana e vet ka të drejtë deri të anulojë akreditimin.

- Vëzhguesit bëjnë pjesë në personat që mund të qëndrojnë në qendrën e votimit. Ata paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja si dhe një dokument identifikimi. Pasi vëzhguesit afatshkurtër (vëzhgues pranë Qendrave të Votimit) i paraqesin KQV-së autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja, KQV-ja shënon në autorizim numrin e QV-së dhe zonën zgjedhore përkatëse, si dhe shënon në procesverbal emrin e vëzhguesit dhe të organizmit të tij, duke bërë kujdes që nga i njëjti organizëm të mos ketë më shumë se dy vëzhgues njëkohësisht për qendër votimi.

- Vëzhguesit, gjatë kryerjes së detyrave të tyre kanë të drejtë të vëzhgojnë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të paraqesin vërejtje me shkrim për çdo lloj parregullsie që vërejnë.

- Vëzhguesit kanë të drejtë të qëndrojnë në qendrën e votimit edhe pas përfundimit të votimit për të vëzhguar procesin e numërimit të votave dhe deri në shpalljen e rezultateve. Ata pajisen, sipas kërkesës së tyre, edhe me një kopje të tabelës së rezultateve të qendrës së votimit.

- Përkthyesit e vëzhguesve të huaj pajisen me dokumentin përkatës, sipas kërkesës së organizmit ndërkombëtar. Përkthyesit mund të shoqërojnë vëzhguesit e huaj në ambientet që “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” ua lejon vëzhguesve, por në asnjë rast ata nuk mund të hyjnë aty vetëm.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

Fletorja Zyrtare gjendet:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 20.4.2001
Doli nga shtypi më 23.4.2001

Tirazhi: 4200 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “At Gjergj Fishta”, Tiranë

Çmimi: 150 lekë